



Udhëzimi / Udhëzimi Udhëzimi / Udhëzimi Udhëzimi / Udhëzimi	23.06	1	118
SKIMSHI 3266/2021			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

**A.nr.461/2021**

Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2768/19 të datës 05.05.2021, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.587/2019 të datës 27.09.2019 të parashtruar nga ankuesi

ne adresë banimi Lagjja "Dragodan", Tregtia C-3, hyrja 6/nr.8, Komuna e Prishtinës, kundër Vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës me numër protokollit 11/559 i datës 01.09.2019, në çështjen juridike "transfer", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.06.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.587/2019 e datës 27.09.2019 e parashtruar nga ankuesi

**II. ANULOHET** Vendimi me Nr.Prot:11/559 i datës 01.09.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, për ri caktimin e z. nga pozita:u.d. Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Operacione, në pozitën e punës Drejtor i Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe Vendimi Nr.II/329 i datës 13/06/2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës mbi caktimin në pozitë të ushtruesit të detyrës të zëvendës drejtorit të përgjithshëm për operacione.

**III. OBLIGOHET** Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës. që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e marrjes së këtij vendimi, ankuesin ta sistemoj në pozitën "Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Operacione", pozitë të cilën ankuesi e ka mbajtur sipas akt emërimit të datës 16/03/2016, si dhe që t'ia llogarisë pjesën e humbur të pagës, duke e bërë kompensimin e diferencës në pagë nga data 02.09.2019 deri me datën e zbatimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### ARSYETIM

Ankuesi i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës sipas Akt emërimit të datës 16.03.2016 me numër protokoll 02/579 në pozitën Zv.Drejtor i Përgjithshëm, Departamenti për Operacione me datë 27.09.2019 ka parashtruar ankesën me numër protokoll 4553/2019 të regjistruar me numër A.nr.587/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. Prot:11/559 të datës 01.09.2019 lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, për ri caktimin e z nga pozita: u.d. Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Operacione, në pozitën e punës Drejtor i Njësisë së Auditimit të Brendshëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 04.10.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Administratën Tatimore të Kosovës. Këshilli, me datë 16.10.2019 ka pranuar përgjigje në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 05.11.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 05.05.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2768/19,ndërsa të protokolluar në gjykatë me nr.01802169 datë 21/05/2021 të pranuar në KPMSHCK-së,me datë 28.05.2021, me të cilin aktgjykim e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 05.11.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vendosë në lidhje me ankesën A.nr.587/2019 të datës 27/09/2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me qëllim të vendosjes meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 27.09.2019 me numër protokoll 4553/2019 të regjistruar me numër A.nr.587/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 04.10.2019 me numër protokoll 4661/2019; E-mail zyrtar i datës 09.09.2019; Vendimi me Nr. Prot:11/559 i datës 01.09.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, për ri caktimin e z nga pozita: u.d. Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Operacione, në pozitën e punës Drejtor i Njësisë së Auditimit të Brendshëm; Vendim i datës 13.06.2019 me numër protokoll 09-06-2528

i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës; Akt emërimi me nr.02/579/01 i datës 16.09.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018 i datës 15.01.2019; E-mail zyrtar i datës 24.06.2019; E-mail zyrtar i datës 16.05.2019; E-mail zyrtar i datës 14.05.2019; Struktura e Përgjithshme Organizative e Administratës Tatimore e datës 10.05.2019; Rregullore Nr.ATK/13/2019 e datës 17.05.2019 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Tatimore të Kosovës; Vendimi i datës 13.06.2019 me numër protokolli 329; Listë distribuimi e datës 14.05.2019 ; Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 09.08.2019 me numër protokolli 171; E-mail zyrtar i datës 16.07.2019 ; Akt emërimi i datës 28.02.2014 me nr.02/408/09 për H.M; Përgjigje në ankesë të datës 16.10.2019 dhe Aktgjykimin me numër A.nr.2768/19 të datës 05.05.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit *, është e bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që Administrata Tatimore e Kosovës në këtë rast Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës ka vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil , Ligjin Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencioneve të Pavarura, Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjin Nr.05/L-021,për mbrojtjen nga diskriminimi, si dhe rregulloret që rregullojnë statusin e nëpunësve civil, ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjate shqyrtimit të provave te lëndës ka konstatuar se ankuesi ka qenë i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës sipas Akt emërimit me numër 02/579/09 të datës 16.03.2016 në pozitën "Zv. Drejtor i Përgjithshëm për Operacione" i cili pas Vendimit me Nr. Prot:11/559 i datës 01.09.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, është transferuar nga pozita: u.d. Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Operacione, në pozitën e punës Drejtor i Njësisë së Auditimit të Brendshëm, duke u bazuar ne nenin 28 dhe 30 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, Ligjin Nr.03/L-222 për administratën tatimore dhe procedurat, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-102 dhe Nr.04/L-223 dhe Rregulloren Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Vendimi me Nr. Prot:11/559 i datës 01.09.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, për ri caktimin e z *nga pozita: "u.d. Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Operacione,* në pozitën e punës Drejtor i Njësisë së Auditimit , është në kundërshtim me dispozitat e nenit 28 dhe 30 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil në Republikës të Kosovës dhe Rregulloren Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil ,nga se në nenin 28 përcaktohet *se:"1. Transferimi i nëpunësve civil mund të bëhet në formë të ri caktimit në vend tjetër të punës dhe si transferim i përkohshëm në detyra tjera. 2.Nëpunësit civilë mund të caktohen, si masë jodisiplinore, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme në vende të tjera pune për ushtrimin e*

funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori funksionale dhe gradë. 3. Ricaktimi mund të bëhet përmes: 3.1. lëvizjes paralele në një zyrë tjetër në kuadër të organizatës së njëjtë ose në organizatë tjetër në të njëjtën kategori funksionale dhe gradë, brenda administratës qendrore ose komunale; 3.2. rotacionit në një zyrë tjetër në të njëjtën kategori funksionale dhe gradë, por me detyra të tjera; dhe 3.3. lëvizja e përkohshme në një organizatë tjetër jashtë shërbimit civil të Kosovës; 3.4. nëpunësi civil, me pëlqimin e tij/saj dhe në marrëveshje me punëdhënësin, mund t'i nënshtrohen transferimit të përkohshëm në detyra të tjera me qëllim të dërgimit në detyrë të veçantë në një organizatë ndërkombëtare, ndërmarrje publike ose në cilëndo organizatë tjetër publike, për të cilën nevojiten aftësi dhe përvojë e caktuar profesionale. 4. Gjatë periudhës së transferimit të përkohshëm nëpunësi civil gëzon statusin e pezullimit të dakorduar sipas nenit 89 të këtij ligji. 5. Ricaktimi i nëpunësve civilë do të rregullohet në hollësi me akte nënligjore. 6. Kushtet e punësimit të mos jenë më të disfavorshme se ato që i ka pasur në vendin e punës" dhe neni 30 ku përcaktohet se: "1. Nëpunësit civilë, me urdhër nga eprori, janë të detyruar që përkohësisht ta zëvendësojnë një koleg i cili mungon ose ta plotësojnë një vend të lirë të punës, nëse veprimtaria e zakonshme e institucionit do të pengohet nga mungesa e nëpunësit civil. 2. Në rast të mungesës së një sekretari të përgjithshëm apo pozicioni ekuivalent, ai/ajo do të zëvendësohet nga nëpunësi civil i rangut më të lartë në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin për procedurën administrative. 3. Refuzimi për zëvendësimin e një nëpunësi civil, që mungon në raste emergjente, konsiderohet pengim i veprimtarisë administrative dhe iu nënshtrohet masave disiplinore. 4. Në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se Vendimi me Nr. Prot:11/559 i datës 01.09.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës është në kundërshtim me dispozitat e nenit 4 dhe nenit 8 të Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil, sepse në vendim fare nuk precizohet se a është transfer i përkohshëm apo i përhershëm dhe nuk përcaktohet kohëzgjatja e transferit, nuk përcaktohet data e kthimit në pozitën e punës sipas Akt emërimit, përkundër që në pjesën e hyrjes së këtij vendimi potencohet vetëm numri i rregullores Nr.06/2010 por pa konkretizuar asnjë dispozitë që argumenton bazën ligjore të këtij vendimi sipas kësaj rregullore, dhe se kjo është edhe një arsye më shumë që ky vendim nuk është i bazuar në Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Vendimi me Nr. Prot:11/559 i datës 01.09.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, për ri caktimin e ankuesit nga pozita:u.d. Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Operacione, në pozitën e punës Drejtor i Njësisë së Auditimit të Brendshëm është në kundërshtim edhe me Ligjin Nr.03/L-222 për administratën tatimore dhe procedurat, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-102 dhe Nr.04/L-223 respektivisht nenin 3 paragrafi 3.1 dhe 3.5, nga se është obligim i zyrtarit kryesorë administrativë në këtë rast Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës që me rastin e emërimit sipas nevojës në ndonjë pozitë duhet domosdoshmërisht të zbatojë dispozitat dhe rregulloret e Shërbimit Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave vlerëson se arsyetimi i këtij vendimi është i paqartë, kundërthënës dhe i pakuptueshëm, për me tepër i njëjti nuk përmban përshkrimin e shkaqeve të cilat kanë qenë vendimtare për nxjerrjen e këtij vendimi ,andaj si i tillë është në kundërshtim me nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.3 dhe 1.5 dhe paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse arsyetimi i vendimit nuk është konformë këtyre dispozitave ligjore.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke ju referuar përgjigjes në ankesë të ATK-së dërguar më datë 15/10/2019, sipas kërkesës së këshillit të datës 19/09/2019, ka konstatuar se e njëjta është dërguar në këshill jashtë afatit ligjor të përcaktuar në nenin 17 paragrafit 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i cili ka përcaktuar se: *"Organi i punësimit është i obliguar që brenda afatit prej pesë (5) ditësh pune, nga dita e pranimit të kërkesës për përgjigje në ankesë, të kthejë përgjigje dhe të ofrojë të gjitha dëshmitë që i kërkon Këshilli"*, ndërsa në rastin konkretë përgjigjja përveç që është dërguar jashtë afatit ligjorë poashtu edhe në përmbajtjen e saj nuk ka ndonjë argumentim juridik që mund të arsyetohet nxjerrja e vendimit të atakuar përmes kësaj ankesë, përveç që përgjigjja kryesisht është e natyrës së përgjithshme e fokusuar në disa çështje që lidhen me riorganizim, anulim të akt emërimeve dhe çështje tjera por që nuk kanë ndonjë ndikim vendimtar sa i përket arsyeshmërisë juridike të nxjerrjes së këtij vendimi dhe vendimeve tjera që lidhen me këtë ankesë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës, ka shqyrtuar edhe pretendimin sa i përket ligjshmërisë së vendimit për shfuqizimin e akteve të emërimit për bartësit aktual të pozitive të punës dhe ka konstatuar se vendimi me Nr.ZQ.09-06-2528 i datës 13/06/2019, nuk prodhon asnjë efekt juridik nga se nuk është i bazuar sepse sipas Ligjit Nr.06/L-113 neni 22 paragrafi 4 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, pozitat e zëvendësuesve të agjencive ekzekutive janë pozita të kategorisë së nivelit të lartë drejtues dhe se përgjegjësia për të ndërmarrë veprime sa i përket anulimit eventual të akt emërimeve është nën kompetencën e komisionit për emërime të larta e jo drejtorit të përgjithshëm të ATK-së, andaj edhe pretendimi ankimor sa i përket anulimit të akt emërimeve mbi bazë të vendimit Nr.ZQ.09-06-2528 të datës 13/06/2019 është i bazuar.

Poashtu nëse i referohemi dispozitave të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura respektivisht nenit 53 pika 1,ku thuhet: *"Ligjet e veçanta që rregullojnë agjencitë ekzekutive ,rregullatore dhe të pavarura të përcaktuara me shtojcën e këtij ligji, do të harmonizohen me këtë ligj, deri më datë 31/12/2021"*, dhe mbi këtë bazë mund të konstatohet fakti se ka qenë obligim i institucionit në këtë rast ATK-së që ligjin dhe aktet nënligjore të institucionit ti harmonizoj me ligjin e ri Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura dhe se çdo veprim pa harmonizim të legjislacionit me ligjin e ri, konsiderohet pa ndonjë efekt juridik, poashtu edhe fakti se ende ka kohë institucioni për harmonizim të legjislacionit mund të kuptohet se veprimet e institucionit në këtë rast ATK-së për anulim të akt emërimeve, risistemimet dhe ricaktimet janë të parakohshme dhe të pabazuara në ligjin që rregullon pozitën e shërbyesve civil dhe Ligjin Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin

e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, dhe poashtu përmes këtyre veprimeve cenojnë interesin e nëpunësve civil, andaj mbi këtë argumentim juridik është i bazuar pretendimi se i janë cenuar të drejtat nëpunësit civil me rastin e nxjerrjes së vendimit për anulimin e akt emërimeve, caktimin në pozitë të u.d.të zv.drejtorit të përgjithshëm, dhe ricaktimin në detyrë tjetër nga ajo që ka pasur akt emërim të datës 16/03/2016.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me rastin e vendosjes duke aplikuar edhe parimin e ligjshmërisë, barazisë, mosdiskriminimit, ekonomizimit dhe efikasitetit në procedurën e përgjithshme administrative, konstaton se me qenë se ankuesi në këshill për vendosje ka edhe një ankesë me objekt afërsisht të ngjashëm A.nr.555/2021 dhe poashtu këshilli dhe ky kolegji ka vendosë në lidhje me lëndën A.nr.484/2021, të ankuesit H.H, me objektë të ngjashëm sa i përket nivelit të pozitës me që rastë këshilli ka aprovuar ankesën dhe ndërlidhur me përgjigjen në ankesë të ATK-së të datës 15/10/2019, në lidhje me ankesën kolegji konstaton, se me rastin e nxjerrjes së Rregullores së datës 17.05.2019 nga ATK-ja, është vërtetuar nga shkresa zyrtare e datës 10.09.2019 me numër protokolli 2781 nga Ministria e Administratës Publike si Ministri kompetente, e cila ka konstatuar se nuk janë respektuar dispozitat e Ligjit Nr.06/113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, nga Administrata Tatimore e Kosovës, me rastin nxjerrjes së Rregullores nr.ATK-13/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të Kosovës, të datës 17.05.2019, sepse nuk ju ka nënshtruar procedurave ligjore siç e përcakton Ligji Nr.06/113, për aprovimin e kësaj rregullore, si dhe Ministria përkatëse e Administratës Publike konstaton pamundësinë e aprovimit të pozitive të lira si rezultat i dilemave që ekzistojnë në organizimin e brendshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, andaj nga kjo shkresë zyrtare nga një organë kompetentë mund të nxjerret përfundimi se Administrata Tatimore e Kosovës, me as një provë nuk ka dëshmuar se ka miratim nga Kryeministri dhe nga ministria përgjegjëse në pajtim me nenin 28 paragrafi 3 ku përcaktohet se : *3. Organizimi i brendshëm i ministrive dhe agjencive ekzekutive miratohet me akt nënligjor nga Kryeministri, në bazë të propozimit të ministrit përgjegjës dhe miratimit paraprak të ministrit përgjegjës për administratën publike dhe opinionit të ministrit përgjegjës për financat*", si dhe paragrafi 6 i Ligjit Nr.06/113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, ku përcakton se: *"6. Qeveria e Kosovës, sipas propozimit të ministrit përgjegjës për administratën publike, miraton Rregulloren për standardet të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, procedurat e detajuara për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm, si dhe përmbajtjen e memorandumit shpjegues të propozimit"*, andaj nga ajo që u tha më lartë dhe që u vërtetua përmes shkrësive të lëndës, nga kolegji u konstatua se nuk ka pasur aprovim konformë nenit 28, paragrafi 3 dhe 6 të Ligjit Nr.06/113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura me rastin e nxjerrjes së Rregullores Nr.ATK-13/2019 të datës 17.05.2019, për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të Kosovës, dhe mbi këtë bazë pretendimet e ankuesit janë të bazuara, sepse vendimi me numër protokolli 11/559 i datës 01.09.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës mbi ricaktimin, vendimi II/329 të datës 13/06/2019 për caktimin në pozitë të ushtruesit të detyrës së zëvendës drejtorit të përgjithshëm për operacione dhe poashtu vendimi Z.Q.09-06-2528 i datës 13/06/2019 mbi anulimin e aktemrimeve nuk janë nxjerrë konformë dispozitave ligjore

në fuqi andaj edhe si i tillë nuk mund të prodhojnë ndonjë efektë juridik në raportë me ankuesin.

Prandaj kolegji referuar përgjigjes zyrtare të ATK-së së datës 15/10/2019 konstaton se përderisa një strukturë organizative e një agjencioni nuk është nxjerrë konformë dispozitave ligjore në fuqi, çdo lëvizje e stafit nga pozitat që kanë me akt emërime mbi bazë të një rregullore të tillë nuk mund të prodhojë ndonjë efekt juridik, dhe se çdo lëvizje e stafit do të duhet të bëhet mbi bazë të procedurave ligjore dhe duke u bazuar në strukturë organizative që ka qenë me fuqi ligjore më herët se kjo që është nxjerrë jashtë procedurave ligjore.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se organi i punësimit në këtë rastë ATK-ja, mbi bazë të provave që egzistojnë në lëndë, përgjigjes në ankesë të ATK-së dhe argumenteve të analizimit të lëndës dhe vendimarrjes me objektë të ngjashëm të lëndës A.nr.484/2021, H.H e cila ishte vendosur nga KPMSHCK-ja, me nxjerrjen e vendimit Z.Q.09-06-2528 të datës 13/06/2019 mbi anulimin e akt emërimeve në këtë rastë të pozitës së zëvendës drejtorit të përgjithshëm për operacione, vendimit II/329 të datës 13/06/2019 për caktimin në pozitë të ushtruesit të detyrës së zëvendës drejtorit të përgjithshëm për operacione dhe vendimit nr.11/559 të datës 01/09/2019 i ricaktimit, ka vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil , Ligjin Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencioneve të Pavarura, Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjin Nr.05/L-021, për mbrojtjen nga diskriminimi, Ligjin Nr.03/L-222 për administratën tatimore dhe procedurat, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-102 dhe Nr.04/L-223, dispozita që u specifikuan më lartë në arsyetim të këtij andaj pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se vendimi Nr.11/559 i datës 01/09/2019, mbi ricaktimin në pozitë të drejtorit të njësisë së auditimit të brendshëm është ngushtë i lidhur me vendimin Z.Q.09-06-2528 të datës 13/06/2019 mbi anulimin e akt emërimeve në këtë rastë të pozitës së zëvendës drejtorit të përgjithshëm për operacione dhe vendimin Nr.II/329 të datës 13/06/2019 për caktimin në pozitë të ushtruesit të detyrës së zëvendës drejtorit të përgjithshëm për operacione, dhe se sipas detyrës zyrtare është kujdesur që të trajtoj këto vendime që kanë lidhshmëri, efektë dhe ndikim vendimtar në vendimin e fundit të ricaktimit dhe me qëllim që të kemi një vendim meritator nga ana e këshillit në lidhje me këtë ankesë duke u fokusuar edhe në parimin e efikasitetit, konstaton se ricaktimi përveq që nuk është i të njejtës kategori funksionale, nuk janë respektuar edhe procedurat ligjore dhe se vendimet që u apostrofuan më lartë janë nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e ligjit material mbi të cilën bazë i është referuar organi i punësimit me rastin e nxjerrjes së tyre.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovë është i obliguar që ankuesin ta kthejë në pozitën "Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm për operacione", të cilën ankuesi e ka mbajtur sipas akt emërimit të datës 16/03/2016, si dhe t'ia llogarisë pjesën e humbur të pagës, duke e bërë kompensimin e diferencës në pagë nga data 02.09.2019 deri në datën e zbatimit të këtij vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmer veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda, A.nr.461/2021, datë 23/06/2021**

Sabile Avdyli  
*Sabile Avdyli*  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.